



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.141

30 dhjetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9651
datë 11.12.2006

Për ratifikimin e ndryshimit në “Marrëveshjen e rishitjes së aksioneve të INSIG sha-së ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”.....

5569

Ligj nr.9652
datë 11.12.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe INALCA SpA, Castelvetro di Modena (Itali) dhe Almed Srl, Trieste (Itali) për riskedulimin e borxheve prapambetura”.....

të 5570

Ligj nr.9653
datë 11.12.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SpA për financimin e programit të rehabilitimit të rrugës Shkodër-Hani i Hotit”.....

5573

Ligj nr.9654
datë 11.12.2006

Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SpA për financimin e programit të rehabilitimit të Portit të Vlorës”.....

5587

Vendim i KM
nr.850, datë 15.12.2006

Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, që janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”.....

5601

LIGJ
Nr.9651, datë 11.12.2006

PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NË “MARRËVESHJEN E RISHITJES SË AKSIONEVE TË INSIG SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR DHE KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE (IFC) E BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi në “Marrëveshjen e rishitjes së aksioneve të INSIG sha-së ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5160, datë 20.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

NDRYSHIM NË MARRËVESHJEN E RISHITJES NDËRMJET BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE KORPORATËS NDËRKOMBËTARE FINANCIARE DHE MINISTRISË SË FINANCAVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR
Datë, 10 gusht 2006

Ndryshimi në marrëveshjen e rishitjes (këtu "Marrëveshja e ndryshimit"), e datës 10 gusht 2006, ndërmjet Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Ministrisë së Financave që vepron në emër të Shtetit Shqiptar në përputhje me ligjin nr.8831, të datës 22 nëntor 2001 mbi pronësinë shtetërore në shoqëritë financiare tregtare me kapital aksionar plotësisht shtetëror, pronar i aksioneve në Institutin e Sigurimeve sh.a. përfaqësuar nga Ministria e Financave (MF).

Ndërsa:

A) më 28 tetor 2003, EBRD, IFC dhe MF (Palët) përfunduan një marrëveshje për blerjen e aksioneve (marrëveshja e blerjes së aksioneve) në pajtim me të cilën MF-ja i shiti EBRD-së aksionet e EBRD-së dhe MF-ja i shiti IFC-së aksionet e IFC-së;

B) në përputhje me termat e Marrëveshjes së blerjes së aksioneve, më 28 tetor 2003, Palët përfunduan një Marrëveshje rishitjeje (Marrëveshja e rishitjes) duke i dhënë EBRD-së dhe IFC-së të drejta të caktuara për të rishitur aksionet e EBRD-së dhe aksionet e IFC-së MF-së, në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara në të; dhe

C) palët dëshirojnë të shtyjnë periudhën e rishitjes së përcaktuar në Marrëveshjen e rishitjes, me qëllim që t'i japin MF-së një periudhë kohe më të gjatë për të identifikuar një investitor strategjik të pranueshëm për EBRD-në dhe IFC-në dhe, si pasojë e saj, të shtyjë ndodhinë e ngjarjes së daljes që do t'i jepte mundësi EBRD-së dhe IFC-së për të ushtruar të drejtat e tyre përkatëse për t'i rishitur MF-së aksionet e EBRD-së dhe IFC-së.

Tashmë, për këtë arsye, Palët bien dakord si më poshtë:

Seksioni 1. Përkufizime. Të gjitha termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje ndryshimi dhe që nuk përkufizohen ndryshe në të, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e rishitjes dhe Marrëveshjen e blerjes së aksioneve.

Seksioni 2. Ndryshim në Marrëveshjen e rishitjes

Seksioni 2.1 Seksioni 1.1 (Interpretimi) i Marrëveshjes së rishitjes ndryshohet me ndryshimin e termit të përkufizuar më poshtë:

“Periudha e rishitjes” nënkupton periudhën që fillon në datën e transferimit dhe përfundon më 31 dhjetor 2007.

Seksioni 3. Hyrja në fuqi. Pas ratifikimit nga Parlamenti, kjo Marrëveshje ndryshimi hyn në fuqi ditën e pesëmbëdhjetë pas botimit të ligjit përkatës që miraton këtë Marrëveshje ndryshimi në Fletoren Zyrtare. Nëse kjo Marrëveshje ndryshimi nuk hyn në fuqi në përputhje me dispozitat e këtij seksioni 3 deri më 30 nëntor 2006, kjo Marrëveshje ndryshimi konsiderohet e pavlefshme ligjërisht, përveçse kur bihet dakord ndryshe nga të gjitha Palët.

Në dëshmi të kësaj, Palët kanë marrë masa për të nënshkruar këtë Marrëveshje ndryshimi në emrat e tyre përkatës sipas datës së shkruar më sipër.

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

Nga: _____

Emri:

Pozicioni:

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Nga: _____

Emri:

Pozicioni:

Korporata Ndërkombëtare Financiare

Nga: _____

Emri:

Pozicioni:

LIGJ

Nr.9652, datë 11.12.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE INALCA SPA, CASTELVETRO DI MODENA (ITALI) DHE ALMED SRL, TRIESTE (ITALI) PËR RISKEDULIMIN E BORXHEVE TË PRAPAMBETURA”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Inalca SpA, Castelvetro di Modena (Itali) dhe Almed Srl, Trieste (Itali) për riskedulimin e borxheve të prapambetura”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5161, datë 20.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE INALCA SPA –

CASTELVETRO DI MODENA (ITALI) DHE ALMED SRL – TRIESTE (ITALY) NË LIDHJE ME
RISKEDULIMIN E BORXHEVE TË PRAPAMBETURA

Marrëveshje e datës __/__/2006, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu e tutje referuar si Këshilli), përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar për Bisedimet e Borxhit të Jashtëm të Shqipërisë (këtu e tutje referuar si GCNEDA), dhe Inalca SpA, përfaqësuar nga z. Paolo Boni dhe Almed Srl, përfaqësuar nga z. Alberto Ghelfi Zoboli.

Neni 1

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i borxheve të prapambetura që rrjedhin nga transaksionet tregtare ndërmjet Inalca SpA dhe Almed Srl dhe ish-ndërmarrjeve shqiptare shtetërore të tregtisë me jashtë.

Shuma e borxheve është si më poshtë:

Nr.	Emri i Shoqërisë	Borxhi	Shuma	Data e maturimit
		USD	ITL	
	Inalca SpA	3.279.244,50		6 qershor, 1993
	Almed Srl		204.955.091,00	22 janar, 1991
	Totali	3.279.244,50	204.955.091,00	

Neni 2

Shuma prej ITL 204.955.091,00 duhet të konvertohet në euro me kursin e caktuar nga Këshilli i Bashkimit Europian më 31 dhjetor 1998. Borxhi ndaj Almed Srl duhet të jetë përkatësisht 105.850,47 euro.

Neni 3

Këshilli shlyen borxhin kundrejt Inalca SpA, në shumën USD 3.279.244,50 në dy këste të barabarta dhe gjysmëvjetore të njëpasnjëshme, i pari do të paguhet më 15 dhjetor 2006 dhe i dyti do të paguhet më 15 qershor 2007.

Këshilli i paguan Inalca SpA interesin për shumën e borxhit në pajtim me nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, me normën e interesit me bazë 6-mujore të Libor-it në vit, për periudhën që fillon në 29 maj 2006 deri në datën e kryerjes së pagesës së kështit të dytë të principalit.

Për periudhën nga 29 maji 2006 deri 15 dhjetor 2006, interesi paguhet më 15 dhjetor 2006 dhe për periudhën që fillon më 16 dhjetor 2006 deri më 15 qershor 2007, interesi është i pagueshëm për shumën e papaguara më 15 qershor 2007.

Neni 4

Këshilli shlyen borxhet kundrejt Almed Srl, në shumën e 105.850,47 euro në një kësht, të pagueshëm më 15 dhjetor 2006.

Këshilli shlyen interesin mbi shumën e borxhit në pajtim me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, me normën e interesit me bazë 6-mujore të Euribor, në vit, për periudhën që fillon më 29 maj 2006 deri në datën e kryerjes së shlyerjes së principalit.

Neni 5

Bazuar mbi kushtin që Këshilli do të paguajë borxhin sipas nenit 3 dhe 4 të mësipërm, Inalca SpA dhe Almed Srl heqin dorë nga kërkesat për interesat e vjetra për periudhën nga data e maturimit të pretendimeve deri në 29 maj 2006.

Neni 6

Në rast vonese në pagesën e kërkueshme në bazë të nenit 3 dhe 4, norma e interesit e përcaktuar në nenin 3 dhe 4 të kësaj Marrëveshjeje rritet me dy për qind, nga data përkatëse për shlyerjen e kësteve deri në datën në të cilën merret pagesa.

Neni 7

Çdo pagesë:

1. Në favor të Inalca SpA bëhet në numrin e llogarisë 5594-2 në bankën e mëposhtme:
BANCA CRV S.p.A. – Viale Mazzini n.1 – 41058 VIGOLA – MODENA – ITALY – ABI: 06365 – CAB: 67070 SÈIFT : CRVGIT2V – IBAN : IT 41 W 06365 67070 000 000 305 594
2. Në favor të Almed Srl bëhet në numrin e llogarisë No.511 në bankën e mëposhtme:
CASSA DL RISPARMIO DI RAVENNA SpA – Via Farini n. 4 – 41100-MODENA – ITALY – ABI: 06270 – CAB: 12900 – SÈIFT: CRRIT 2R – IBAN: IT 41 M 062900 CC0530000511.

Neni 8

Kjo Marrëveshje nuk ndryshohet pa pëlqimin me shkrim të të dyja Palëve.

Neni 9

Njoftimet e bëra në pajtim me këtë Marrëveshje adresohen si më poshtë:

Këshilli
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tirana, Shqipëri
Tel : ++3554228405
Fax: ++3554229200

Inalca SpA
Via Spilamberto n.30/C – 41014 Castelvetro di Modena (Italy)
Tel: ++ 39 059755111
Fax: ++ 39059755517

Almed Srl
Avv. Alberto Ghelfi Zoboli
Corso Canalgrande n.23 – 41100 Modena (Italy)
Tel: ++ 39 059236487
Fax: ++ 39059214823

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të nevojshme ligjore që kërkohen nga legjislati shqiptar dhe është e vlefshme dhe detyruese derisa Palët të përmbushin detyrimet e tyre që parashikohen në të.

Bërë në Tiranë, më.....2006, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Në emër të Këshillit të Ministrave
të Republikës së Shqipërisë
z. Ridvan BODE

Në emër të
Inalca SpA
z. Paolo Boni

Në emër të
Almed Srl
z. Alberto Ghelfi Zoboli

LIGJ

Nr.9653, datë 11.12.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE ARTIGIANCASSA SPA PËR FINANÇIMIN E PROGRAMIT TË**

REHABILITIMIT TË RRUGËS SHKODËR-HANI I HOTIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SpA për financimin e programit të rehabilitimit të rrugës Shkodër-Hani i Hotit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5162, datë 20.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

F.ROT. /AID 06/006/00

MARRËVESHJE FINANCIARE

MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE DHE ARTIGIANCASSA SPA DERI NE SHUMËN PREJ 21.700.000,00 EURO "PROGRAMI PËR REHABILITIMIN E RRUGËS SHKODËR- HANI I HOTIT"

- Këshilli i Ministrave i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (këtu e tutje referuar si Huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave nga njëra anë dhe

- Artigiancassa S.p.A. listuar në regjistrin e bankave, me kapital aksionesh prej 35.000.000,00 euro, me seli në Romë, Via Crescenzo Del Monte 25, regjistruar në regjistrin e firmave, kodi i taksave nr.01158450583, TVSH nr.00968081000 (këtu e tutje referuar si Artigiancassa), si administrator, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës Italiane të Fondit të Përsëritshëm për Bashkëpunim Zhvillimi, krijuar në bazë të nenit 26 të ligjit italian nr.227 i datës 24 maj 1977, dhe më tej i referuar në nenin 6 të ligjit italian nr.49 të datës 26 shkurt 1987, përfaqësuar nga Z. nga ana tjetër (Artigiancassa dhe Huamarrësi së bashku, këtu e tutje referuar si "Palët")

kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje financiare:

Neni 1

Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- "Njohja e borxhit" nënkupton deklaratën e referuar sipas nenit 10, me anë të së cilës Huamarrësi ndërmerr në favor të Artigiancassa-s të rimbursojë kapitalin plus interesin së bashku të pagueshëm, në lidhje me huanë e butë.

- "Banka agjente" nënkupton institucionin financiar (Artigiancassa), i cili do të jetë i përfshirë në aktivitetet e mëposhtme:

- rishikim i dokumentacionit kontraktual;
- operacionet e disbursimit;
- operacionet e pagesës.

- "Marrëveshja" nënkupton këtë Marrëveshje financiare, hyrjen dhe shtojcat përkatëse që formojnë pjesë përbërëse të saj.

- "Banka Agjente Shqiptare" nënkupton bankën lokale të caktuar nga Huamarrësi si banka

korresponduese e Artigiancassa-s që vepron si bankë agjente e Huamarrësit për qëllim të kësaj Marrëveshjeje.

“Autoriteti kompetent i Huamarrësit” nënkupton Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.

- "Dokumentacioni kontraktual" nënkupton dokumentacionin e referuar në kontratën/kontratat e furnizimit (faturat, fletëngarkesat, lista e paketimit, puna në progres etj.).

- "Periudha e shtyrjes së afatit " nënkupton periudhën që zgjat 228 muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë.

- "Autoritetet kompetente italiane" nënkuptojnë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe/ose Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Italiane dhe/ose çdo ent tjetër kompetent të Qeverisë së Republikës Italiane, të caktuar për qëllim të kësaj Marrëveshjeje.

- “MAE/DGCS” nënkupton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Italiane, Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim Zhvillimi.

- “MPWTT” nënkupton Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë, e cila siguron zbatimin e programit dhe është nënshkruese e kontratave.

- “Programi” nënkupton programin në lidhje me “Rehabilitimin e rrugës Shkodër- Hani i Hotit”.

- “Kërkesa e datës së disbursimit” nënkupton datën e mbërritjes në Artigiancassa të kërkesës së disbursimit, siguruar nga eksportuesi italian në formularin e shtojcës B.

- "Hua e butë" nënkupton financimin që Artigiancassa, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, jep në lidhje me termat dhe kushtet e parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

- "Kontrata/kontratat e furnizimit" nënkupton kontratën/kontratat tregtare në lidhje me furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve nga eksportuesit italianë për importuesit shqiptarë, për sa i përket realizimit të programit.

Neni 2

Hyrje

2.1 Me anë të Marrëveshjes së njohur si “Marrëveshje qeveritare” (këtu e tutje referuar si “Marrëveshja qeveritare”) nënshkruar më ... midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga MPWTT dhe Qeverisë së Republikës Italiane, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, kjo e fundit është angazhuar të financojë programin nëpërmjet një huaje të butë deri në shumën maksimale prej 21.700.000,00 (njëzet e një milion e shtatëqind mijë/00) eurosh.

2.2 Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Palët synojnë: (i) të zbatojnë kushtet financiare në lidhje me huanë e butë të parashtruar në Marrëveshjen qeveritare; dhe (ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me Marrëveshjen qeveritare.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Qeverisë së Republikës Italiane, me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Italiane, me dekretin nr.28216 të datës 14 mars 2006, ka autorizuar Artigiancassa-n t’i japë Huamarrësit një hua të butë në bazë të termave dhe kushteve të parashtruara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje (këtu e tutje referuar si “Huaja e butë”) për qëllim të financimit të programit.

Neni 3

Huaja e butë

3.1 Artigiancassa i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon huanë e butë me kushtet e mëposhtme:

- Shuma maksimale deri në 21.700.000,00 (njëzet e një milion e shtatëqind mijë/00) euro.

- Kohëzgjatja: 39 vjet.

- Ripagesa: 40 (dyzet) këste principali gjashtëmujore të njëpasnjëshme të barabarta, i pari i të cilëve duhet paguar 228 (dyqind e njëzet e tetë) muaj nga data e disbursimit të parë.

- Norma e interesit: norma vjetore nominale 0,00% (zero pikë zero zero për qind).

- Qëllimi i huasë: “Programi për rehabilitimin e rrugës Shkodër – Hani Hotit”.

3.2 Shuma maksimale e përmendur në këtë Marrëveshje, e barabartë me 21.700.000,00 euro, duhet të konsiderohet vetëm si shumë tavan. Shuma e vërtetë e huasë së butë do të rezultojë nga shuma totale e kontratave të furnizimit të alokuara për huanë e butë.

Në rast se shuma e vërtetë duhet të jetë më e ulët se ajo e përmendur, shuma e mbetur e papërfshirë në shumën totale të kontratave të furnizimit të alokuara për huanë e butë do të konsiderohet e padisponueshme për huanë e butë.

3.3 Huaja e butë do të përdoret për të siguruar mallra dhe shërbime me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 45 % (dyzet e pesë për qind) e shumës në lidhje me huanë e butë, mund të përdoret për të mbuluar shpenzimet lokale dhe importin e mallrave dhe shërbimeve që e kanë origjinën nga vende të tjera në zhvillim.

Kontratat e furnizimit do të caktohen në euro.

3.4 Huaja e butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- Taksa lokale, tatime doganore, TVSH.

3.5 Kontratat e furnizimit në lidhje me programin sipas nenit 2.1 do të prokurohen nëpërmjet ofertës publike të rezervuar për kompanitë italiane mbi bazën e procedurave të parashikuara në “Manuale delle procedure” (miratuar nga Komisioni European më 23 dhjetor 2002) në lidhje me shërbime, furnizime dhe kontrata punimesh të financuara nga buxheti i përgjithshëm i KE-së, në kontekstin e bashkëpunimit me vendet e treta.

3.6 Huaja e butë do të vihet në dispozicion në përputhje me termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

4.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pasi Artigiancassa të ketë marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme nëpërmjet Ambasadës Italiane -L'Ambasciata/UTL:

i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke i kërkuar autoritetit të Huamarrësit të nënshkruajë në emër dhe për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë këtë Marrëveshje nga një person i autorizuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Shqipëri dhe të ndërmarrë detyrimet që lindin nga kjo Marrëveshje;

ii) Caktimin me shkrim nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë i personit/personave të autorizuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje (certifikuar nga Ambasada Italiane në Tiranë- l'Ambasciata/UTL), kërkesa për financim të kontratës së furnizimit në formularin e shtojcës A) dhe njohja e borxhit në formularin e shtojcës E), referuar sipas nenit 10 më poshtë. Ky përcaktim do të specifikojë emrin dhe pozicionin e këtij personi/këtyre personave dhe do të përmbajë “formularin tip” të deritanishëm të tij. Çdo modifikim në të (nëse ka) do të transmetohet në kohë nga Huamarrësi për Artigiancassa-n;

iii) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me caktimin e Bankës Agjente Shqiptare, duke i kërkuar autoritetit të Bankës Agjente Shqiptare të veprojë në emër dhe për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Me marrjen dhe plotësimin e dokumenteve të sipërpërmendura, Artigiancassa do të njoftojë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Agjente Shqiptare me anë të një letre ose faksi që do të konfirmohet më pas me një letër, në lidhje me datën në të cilën kjo Marrëveshje do të ketë hyrë në fuqi.

Neni 5

Termi për disbursimin e huasë së butë

5.1 Periudha e disbursimit të huasë së butë do të jetë 36 muaj pas datës së disbursimit të parë. Kjo periudhë mund të shtyhet nga Artigiancassa. Kjo e fundit nuk mund ta shtyjë periudhën e disbursimit në rast se Huamarrësi ose autoritetet kompetente italiane nuk bien dakord për këtë shtyrje dhe kanë njoftuar për këtë me shkrim Artigiancassa-n të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para datës së mbarimit të periudhës së disbursimit.

5.2 Në rast se periudha e disbursimit ka përfunduar dhe nuk mund të shtyhet, pasi të jetë konsultuar me autoritetet kompetente italiane, Artigiancassa do të informojë Huamarrësin në lidhje me anulimin e angazhimit të Artigiancassa-s mbi fondet e papërdorura.

Neni 6

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e huasë së butë

6.1 Huaja e butë mund të përdoret nga Huamarrësi pas plotësimit të kushteve të mëposhtme:

- i) autorizim i dhënë nga autoritetet kompetente italiane për të alokuar kontratën/kontratat e furnizimit për huanë e butë;
- ii) rezultat i suksesshëm i hetimit të kryer nga Artigiancassa, sipas nenit 6.2 (i) më poshtë;
- iii) marrja e kërkesës së Artigiancassa-s për financimin e kontratës së furnizimit, parashikuar nga neni 7.1 më poshtë.

6.2 Me marrjen e autorizimit të përmendur, sipas 6.1 (i) më sipër, Artigiancassa do të procedojë menjëherë si më poshtë:

i) Të kryejë kontroll, mbi bazën e kërkesave të parashikuara nga autoritetet kompetente italiane mbi eksportuesin italian dhe mbi individët/firmat italiane (nëse ka) të përfshira me organizatën lokale dhe mbi kontratën/kontratave të furnizimit. Për sa i përket kontratës/kontratave të furnizimit, Artigiancassa do të verifikojë që ato të jenë në përputhje me termat dhe kushtet e huasë së butë dhe të jenë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me rënien e shpenzimeve/çmimeve, me qëllim që të lejojë hetimet e parashikuara në nenin 8.1;

ii) Të njoftojë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Agjente Shqiptare mbi përvetësimin e autorizimit sipas nenit 6.1 i) më sipër dhe t'i kërkojë Bankës Agjente Shqiptare të paraqesë kërkesën e parashikuar në nenin 7.1.

6.3 Rezultati i suksesshëm i hetimit të kryer nga Artigiancassa sipas nenit 6.2 (i) më sipër do të shkaktojë alokimin e kontratës/kontratave të furnizimit për huanë e butë. Financimi i kontratës së furnizimit do të bëhet vetëm me plotësimin e kushtit të parashtruar në nenin 6.1 (iii).

6.4 Artigiancassa do të njoftojë me anë të një letre ose teleksi/faksimileje Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, Bankën Agjente Shqiptare, eksportuesin italian dhe MAE/DGCS të alokimit, si dhe financimin e kontratës/kontratave të furnizimit.

Neni 7

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit

7.1 Pas njoftimit në lidhje me rezultatin e suksesshëm të hetimit, sipas nenit 6.2 (i), Banka Agjente Shqiptare do t'i transmetojë Artigiancassa-s një kërkesë për financimin e kontratës së furnizimit, të nevojshme për pagesat e parashikuara në secilën kontratë furnizimi. Me anë të kësaj kërkesë, e cila do të jetë në formularin e shtojcës A), Banka Agjente Shqiptare do të pohojë se kontrata/kontratave të furnizimit është/janë të pranueshme për t'u financuar dhe do të ndërmarrë t'i rimbursojë Artigiancassa-s sasinë e disbursuar.

7.2 Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit e parashikuar në nenin 7.1 do të merret në kohën e duhur dhe në asnjë rast jo më vonë se gjashtë muaj nga data e njoftimit nga Artigiancassa, parashikuar në nenin 6.4 më sipër ose afatin (nëse ka) të parashikuar në kontratën e furnizimit. Pas përfundimit të periudhës së sipërpërmendur, pas konsultimit me autoritetet kompetente italiane, Artigiancassa do të shqyrtojë anulimin e mundshëm të kontratës/kontratave të furnizimit, alokuar për huanë e butë.

Neni 8

Procedura e disbursimit

8.1 Eksportuesi italian do t'i dorëzojë dokumentacionin kontraktual Artigiancassa-s dhe do të kërkojë disbursimin në përputhje me kontratën e furnizimit të sasisë përkatëse në formularin e shtojcës B). Artigiancassa do të informojë menjëherë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, Bankën Agjente Shqiptare dhe MPWTT me anë të mesazhit me telefaks që dokumentacioni kontraktual është paraqitur, duke specifikuar kërkesën e datës së disbursimit. Artigiancassa do të rishikojë menjëherë dokumentacionin kontraktual. Ky rishikim do të përfshijë përputhshmërinë e dokumentacionit kontraktual me kontratën përkatëse të furnizimit.

8.2 Në rast se rezultati i rishikimit është i suksesshëm, brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike pas kërkesës së datës së disbursimit, Artigiancassa do t'i postojë me rrugë diplomatike një kopje origjinale të dokumentacionit kontraktual Bankës Agjente Shqiptare. Kjo e fundit, nëse nuk vëren mospërputhje, do t'i dërgojë Artigiancassa-s autorizimin e disbursimit në formularin e shtojcës C) që duhet të bazohet në

reagimin pozitiv të dhënë nga MPWTT bankës agente shqiptare brenda 27 (njëzet e shtatë) ditësh kalendarike pas kërkesës së datës së disbursimit. Nëse Banka Agjente Shqiptare nuk arrin të paraqesë kërkesën e pagesës Artigiancassa-s brenda periudhës së përmendur prej 27 (njëzet e shtatë) ditësh, pas kalimit të 7 (shtatë) ditësh kalendarike nga data e lartpërmendur e përfundimit, Artigiancassa do të autorizohet në mënyrë të paravokueshme t'i disbursojë fondet eksportuesit italian.

8.3 Në rast se Artigiancassa vëren disa mospërputhje në dokumentacionin kontraktual, do të informojë me anë të telefaksit eksportuesin italian dhe Bankën Agjente Shqiptare brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike pas kërkesës së datës së disbursimit. Eksportuesi italian duhet t'i dërgojë dokumentet e korrigjuara Artigiancassa-s brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike pas datës së njoftimit të dërguar nga Artigiancassa. Artigiancassa do të postojë menjëherë me rrugë diplomatike dokumentet origjinale të korrigjuara Bankës Agjente Shqiptare. Që këtej e tutje do të zbatohet procedura e përmendur në nenin 8.2

8.4 Në rast se Banka Agjente Shqiptare vëren disa mospërputhje në dokumentacionin kontraktual dhe/ose MPWTT jep një reagim negativ, Banka Agjente Shqiptare duhet të informojë Artigiancassa për atë qëllim brenda 27 (njëzet e shtatë) ditësh pas kërkesës së datës së disbursimit, duke u kujdesur t'i kthejë Artigiancassa-s me postë me rrugë diplomatike origjinalin e dokumentacionit kontraktual. Me marrjen e këtij njoftimi, Artigiancassa do të informojë menjëherë eksportuesin italian në lidhje me mospërputhjet dhe/ose pretendimet e MPWTT, me kërkesën e dokumenteve të korrigjuara. Që këtej e tutje do të zbatohet procedura e përmendur në nenin 8.3 dhe më pas 8.2. Në rast mosmarrëveshjes, çështja do të rregullohet sipas asaj çfarë është parashikuar në kontratën e furnizimit. Pagesa do të ekzekutohet vetëm pas zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, pas së cilës do të zbatohet procedura e parashikuar në nenin 8.2.

8.5 Artigiancassa do të bëjë pagesat në favor të eksportuesit/eksportuesve italianë dhe do të marrë nga ky eksportues/këta eksportues italianë faturën e lëshimit, të parashikuar në shtojcën D në dy origjinale, njëri prej të cilëve do t'i dërgohet Bankës Agjente Shqiptare.

8.6 Pas çdo pagese në favor të eksportuesit/eksportuesve italianë, Artigiancassa do t'i dërgojë me shkrim Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Agjente Shqiptare një program ripagese të sasisë së disbursuar, duke cilësuar datat e maturimit në lidhje me të, në përputhje me nenin 9 më poshtë. Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të konfirmojë me shkrim pranimin e saj të programit të mësipërm të ripagimit.

Neni 9

Ripagimi i huasë së butë

9.1 Çdo sasi e disbursuar do të ripaguhet sipas programit të ripagimit në 40 kështe të shtyra gjashtëmujore të njëpasnjëshme të barabarta (këtu e tutje referuar si "Këstet e principalit"), i pari i të cilëve duhet të paguhet 228 (dyqind e njëzet e tetë) muaj pas datës së disbursimit të parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Agjente Shqiptare programin e ripagimit në përputhje me nenin 8.6.

9.2 Në lidhje me këstet e principalit të papaguar, të kredituara efektivisht, interesi i shtyrë do të llogaritet me një përqindje vjetore nominale prej 0,00% (zero pikë zero zero për qind).

9.3 Banka Agjente Shqiptare, në emër dhe për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, ndërmerr të kryejë pa vonesë të gjitha pagesat dhe ripagesat e maturimit sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe sipas njohjes së borxhit: mbi datën aktuale të maturimit për shumën korresponduese në euro, në favor të Artigiancassa ose personit/personave të autorizuar për këtë. Këto shuma do të kreditohen pa zbritje të ndonjë banke dhe/ose kurs këmbimi dhe/ose taksa dhe pa njoftim në lidhje me këtë nga Artigiancassa ose nga personat e autorizuar që kërkohen për këtë. Për çdo ripagesë, Banka Agjente Shqiptare do t'i tregojë Artigiancassa-s numrin e Marrëveshjes financiare dhe shumën totale të huasë së butë dhe do të specifikojë për çdo datë maturimi shumat e paguara.

Neni 10

Dorëzimi i njohjes së borxhit

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e fundit e përfundimit të disbursimit të huasë së butë, parashtruar në nenin 5.1, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do t'i dërgojë Artigiancassa njohjen e borxhit, të nënshkruar dhe të shënuar me initiale nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë në secilën faqe, në formularin e shtojcës E).

10.2 Programi i ripagesës i parashtruar në njohjen e borxhit do të plotësohet me anë të

përmbledhjes së të gjitha kësteve të principalit dhe interesit, ende të pamaturuara dhe këstet të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar në datën e dërgimit të njohjes së borxhit, parashikuar në programin përkatës të ripagesës për secilin disbursim, në përputhje me dispozitat e nenit 8.6.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë njohjen e borxhit për regjistrim dhe administrim të saj dhe herë pas here do të shënojë mbi njohjen e borxhit çdo pagesë të principalit dhe interesit së bashku me këstet e mundshme që janë maturuar, por nuk janë paguar. Sapo të jenë bërë të gjitha pagesat e shqyrtuara në njohjen e borxhit, Artigiancassa do t'i kthejë njohjen e borxhit Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar për marrje.

Neni 11

Angazhimi i Huamarrësit

Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat sipas kësaj Marrëveshjeje dhe njohjen e borxhit në lidhje me të, është i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 12

Pengesat dhe forcat madhore

Në rast pengesash ndaj zbatimit të programit për shkak të forcave madhore (si luftë, përmytje, zjarre, tërmete, konflikte pune dhe greva, akte të ndonjë qeverie, vështirësi të papritura transporti, pune dhe arsye të tjera) do të zbatohen dispozitat e specifikuara në nenin 12 të Marrëveshjes qeveritare. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e autoriteteve kompetente italiane në lidhje me aktivitetet e programit.

Neni 13

Pezullimi i disbursimit

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të huasë së butë, Artigiancassa rezervon të drejtën për të pezulluar çdo kërkesë disbursimi sipas nenit 8, në rast se ndodh ndonjë mospagim ndaj Artigiancassa-s sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo huaje tjetër financiare dhënë nga Qeveria e Republikës Italiane Qeverisë ose bankës qendrore apo agjencive shtetërore të Republikës së Shqipërisë sipas nenit 6 të ligjit nr.38 të datës 9 shkurt 1979 dhe nenit 6 të ligjit nr.49 të datës 26 shkurt 1987 të Republikës Italiane, siç është amenduar herë pas here. Artigiancassa do të informojë në kohë Huamarrësin dhe Bankën Agjente Shqiptare në lidhje me këtë pezullim.

13.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo kërkesë disbursimi të parashikuar në nenin 8, në rast se shumat korresponduese janë vënë në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane. Artigiancassa nuk do të konsiderohet përgjegjëse përballë Huamarrësit në rast se shumat që do të disbursohen sipas huasë së butë nuk do të vihen në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 14

Interesi i mospagimit

14.1 Nëse për çfarëdolloj arsyeje, Artigiancassa nuk merr shumat e pagueshme për principalin dhe ose interesin brenda datës së maturimit, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë Artigiancassa-s, në lidhje me shumat e mësipërme, interesin e mospagimit nga data e maturimit deri në datën e kreditimit aktual në favor të Artigiancassa-s ose të personit/personave të autorizuar për këtë.

14.2 Ky interes mospagimi do të llogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë.

Interesi i mospagimit nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh menjëherë pas datës fillestare të maturimit dhe më pas do të llogaritet me përqindjen prej 2,5% (dy pikë pesë për qind) deri në datën e kreditimit aktual në favor të Artigiancassa-s. Interesi i mospagimit të kësaj të fundit do të rinovohet periodikisht nga autoritetet kompetente italiane.

14.3 Rishikimi synon të sjellë interesin e mospagimit në linjë me dhe për asnjë arsye jo më lart se norma e referencës së interesit tregtar, të publikuar çdo muaj nga OECD.

Neni 15

Taksat

15.1 Çdo taksë aktuale ose e ardhshme, e cila mund të jetë e pagueshme në Shqipëri për çfarëdolloj arsyeje në lidhje me këtë Marrëveshje dhe njohjen e borxhit, do të përballohet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

15.2 Çdo taksë e pagueshme në Itali në lidhje me këtë Marrëveshje nuk do të përballohet nga Huamarrësi.

15.3 Artigiancassa deklaroi se do të përdorë statusin e taksës, të parashikuar në nenin 19 të dekretit të Presidentit të Republikës nr.60l i datës 29 shtator 1973, siç është amenduar herë pas here.

Neni 16 **Ligji rregullues**

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

17.1 Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë paqësore çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi dhe/ose performanca e kësaj Marrëveshjeje.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk duhet të çojnë në një zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda një periudhe të arsyeshme kohore, mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

17.3 Nëse kjo përpjekje dështon ose (nëse përpjekja është bërë) kjo nuk çon në një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen përfundimisht sipas rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris, Francë, nga një Gjykatë Arbitrazhi e tre gjyqtarëve arbitrazhi:

- Një gjyqtar arbitrazhi i caktuar nga Huamarrësi;
- Një gjyqtar arbitrazhi i caktuar nga Artigiancassa;
- Gjyqtari i tretë i arbitrazhit do të caktohet nga gjyqtarët e mësipërm të arbitrazhit, ose në rast të mosrënies së tyre dakord, nga Kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk cakton gjyqtarin e tij të arbitrazhit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga kërkesa e palës tjetër, ky gjyqtar arbitrazhi do të caktohet nga Kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, e cila vendos sipas ligjit të Republikës Italiane, do të jetë i formës së prerë dhe i detyrueshëm pa kushte për të dyja palët, pa mundësi apelimi.

17.6 Asnjë konflikt apo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Palëve të kësaj Marrëveshjeje nuk do të pezullojë detyrimin e Huamarrësit për të paguar në datat e maturimit të rëna dakord, të gjitha shumatat e maturimit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe veçanërisht të gjitha shumatat që rezultojnë nga programet e ripagesës të parashtruara në nenin 8 më lart dhe nga njohja e borxhit në lidhje me të.

Neni 18 **Njoftimet**

Njoftimet që do jepen sipas kësaj Marrëveshjeje, do të dorëzohen në adresat e mëposhtme:

- Ministria e Financave: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” n.4– Tirana Albania

Tel.: +355 -4- 250264 - Fax: +355 -4- 228494

- Artigiancassa SpA. -Via Crescenzo del Monte 25, - 00153 Romë Italy

Tel Zyrë +39-06-5845414/509; Fax +39-06/5845466

- Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

- Banka Agjente Shqiptare: Adresa do të sigurohet para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19 **Tekstet origjinale të Marrëveshjes financiare**

Kjo Marrëveshje do të jetë në tri origjinale në gjuhën angleze. Artigiancassa ruan dy origjinale dhe Huamarrësi ruan një origjinal.

Artigiancassa S.p.A.

Këshilli i Ministrave i Republikës
së Shqipërisë, përfaqësuar

Nënshkruar në ... më ... nga Ministria e Financave
Nënshkruar në ... më ...

FORMULARI I KËRKESËS PËR FINANCIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT

SHTOJCA A

Nga: (Banka Agjente Shqiptare në emër dhe për Huamarrësin)

Për: Artigiancassa S.p.A.

Marrëveshje financiare prej(.....) euro, nënshkruar nga në
më dhe nga Artigiancassa në.... më

Sipas nenit 7 të Marrëveshjes financiare të mësipërme, ne do të donim t’iu informonim se kontrata e furnizimit bashkëlidhur me nr....e datës.....midis dhe në lidhje me (programi), është e pranueshme për financim.

Si rrjedhojë, ne iu kërkojmë të financoni shumën përkatëse prej (.....) euro e cila korrespondon me pagesat e maturimit nga ana jonë për(eksportuesi italian), që ju do të bëni në përputhje me termat e kontratës së furnizimit.

Për këtë qëllim, ne pohojmë se pagesat që ju do të bëni në favor të eksportuesit italian të treguara nga ne, do të varen nga procedura e përmendur në nenin 8 të Marrëveshjes financiare.

Në këtë kontekst, ju do të na transmetoni origjinalin e dokumentacionit kontraktual, si dhe një prej dy origjinaleve të kësaj fature lëshimi.

Ne konfirmojmë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ndërmerr pa kushte dhe në formë të parevokueshme të ripaguajë çdo shumë të kredituar nga ju në llogarinë e eksportuesit italian, sipas

termave dhe kushteve të parashikuara sipas Marrëveshjes financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e fundit e përfundimit të disbursimit të huasë së butë parashtruar në nenin 5 të Marrëveshjes financiare, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të dorëzojë një njohje borxhi për shumën e principalit që i korrespondon shumës totale të gjithë disbursimit të bërë sipas Marrëveshjes financiare.

Kjo njohje borxhi do të jetë në formularin e shtojcës E të Marrëveshjes financiare.

Me respekt,

Data,

Firma

FORMULARI I KËRKESËS SË DISBURSIMIT

SHTOJCA B

Nga:(Eksportuesi italian)

Për : Artigiancassa S.p.A.

Kopje për: Bankën Agjente Shqiptare

Marrëveshje financiare prej(....) euro, nënshkruar nga në..... më dhe nga Artigiancassa S.p.A në më

Të nderuar zotërinj,

Duke iu referuar kontratës së furnizimit nr. të datës midis nesh dhe..... (importuesit) për shumën prej(.....) në lidhje me (programi/projekti), ne po iu dërgojmë dokumentacionin e mëposhtëm kontraktual:

.....

.....

.....

Ju kërkojmë që shuma e lartpërmendur të disbursohet nga ju, me autorizimin e Bankës Agjente Shqiptare, në llogarinë e mëposhtme bankare (Banka e eksportuesit italian):

BBAN: Hapur në emër të :..... Banka: nr. tel zyrë dege:..... nr. faks zyrë dege:.....

Me respekt,

Datë,

Firma

Në lidhje me këtë, konfirmojmë vërtetësinë e firmës.

.....

(Banka e eksportuesit italian)

AUTORIZIMI I FORMULARIT TË DISBURSIMIT

SHTOJCA C

Nga: (Banka Agjente Shqiptare në emër dhe për Huamarrësin)

Për: Artigiancassa S.p.A.

Marrëveshje financiare prej..... (.....) euro, nënshkruar nga në..... më..... dhe nga Artigiancassa në më

Të nderuar zotërinj,

Sipas nenit 8 të Marrëveshjes financiare të lartpërmendur, ne do donim t'ju informonim se kemi marrë dokumentacionin kontraktual, duke iu referuar kontratës së furnizimit bashkëlidhur nr. e datës..... midis dhe në lidhje me (programi).

Mbi bazën e reagimit pozitiv të dhënë nga MPWTT, ne ju autorizojmë të paguani kundërvlerën e dokumenteve përkatëse në favor të.... (Eksportuesi italian).

Me respekt,

Data

Firma

FORMULARI I FATURËS SË LËSHIMIT

SHTOJCA D

Nga: Eksportuesi italian

për: (Bankën Agjente Shqiptare në emër dhe për Huamarrësin)

për: Artigiancassa S.p.A.

FATURË LËSHIMI

Duke iu referuar kontratës së furnizimit nr. nënshkruar më..... midis firmës sonë dhe për furnizimin e, ju konfirmojmë të kemi marrë shumën prej(.....) euro, si pagesë të pjesshme/totale të kësaj kontrate furnizimi.

Kjo shumë ka lidhje me huanë e butë prej(.....) euro, dhënë nga Artigiancassa qeverisë së....., sipas nenit 6 të ligjit nr.49 të datës 26 shkurt 1987, siç amendohet më tej herë pas here me anë të Marrëveshjes financiare, të nënshkruar në më dhe në ... më..... .

Për këtë arsye, ne konfirmojmë të jemi paguar plotësisht për shumën e pjesshme/totale të pagueshme sipas huasë së butë, si pagesë e shumës prej(.....) euro dhe se Huamarrësi, Banka Agjente Shqiptare dhe Artigiancassa nuk janë përgjegjës për ndonjë dhe të gjitha tarifat dhe përgjegjësinë në lidhje me shumën e marrë.

Data

Nënshkrimi

Në lidhje me këtë, konfirmojmë vërtetësinë e firmës.

.....

(Banka e eksportuesit italian)

FORMULARI I NJOHJES SË BORXHIT

SHTOJCA E

..... (Huamarrësi)

Nr.

Vendi dhe data e lëshimit:

.....

Në lidhje me Marrëveshjen financiare midis (Huamarrësit), që vepron për dhe në emër të Qeverisë së.....dhe Artigiancassa, nënshkruar në më dhe në më, (Huamarrësi) pohojmë marrjen e shumave të mëposhtme nga Artigiancassa:

..... më

..... më

.....

Rrjedhimisht, (Huamarrësi) deklaron në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme të jetë debitor i Artigiancassa-s, si administrator i fondit të përsëritshëm për bashkëpunim zhvillimi në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Italisë, - me seli në Romë (Itali), Via Crescenzo del Monte 25, për shumën e principalit prej (.....) euro, e cila ndërmerr të ripaguajë në .. (.....) këtë të shtyra gjashtëmujore të njëpasnjëshme të barabarta, i pari i të cilëve duhet të paguhet më dhe i fundit më, sipas programit të ripagimit të parashtruar më poshtë.

Mbi shumën e principalit të papaguar të kësaj njohjeje borxhi, (Huamarrësi) ndërmerr të paguajë interesin e referuar në programin e ripagimit të parashtruar më poshtë, llogaritur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes financiare.

..... (Huamarrësi) do të ripaguajë këstet e principalit dhe do të paguajë interesin e parashikuar në këtë njohje borxhi, duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datat e maturimit të rëna dakord, në favor të Artigiancassa-s ose të personave të autorizuar për këtë, me zyrën e degës në Romë të Artigiancassa S.p.A., të çliruar nga çdo detyrim bankar dhe/ose këmbimi.

Nëse me zyrën e degës në Romë të Artigiancassa-s S.p.A., për çfarëdo arsyeje, duke përfshirë arsyet përtej kontrollit të Huamarrësit, nuk merr shumat e pagueshme për principalin dhe interesin e parashikuar në këtë njohje borxhi brenda datës së maturimit, Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë në zyrën e degës në Romë të Artigiancassa S.p.A., mbi këto shuma, interes mospagimi nga data e maturimit deri në datën e kreditimit aktual në favor të Artigiancassa-s ose të personit/personave të autorizuar për këtë.

Ky interes mospagimi do të llogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë. Interesi i mospagimit nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh menjëherë pas datës fillestare të maturimit dhe më pas, do të llogaritet në përqindjen prej 2,5% deri në datën e kreditimit aktual në favor të Artigiancassa-s.

.....

(Inicialet e Huamarrësit)

Interesi i mospagimit të kësaj të fundit do të rinovohet periodikisht nga autoritetet kompetente italiane; ky rinovim do të bëhet nga data 1 janar 2007. Artigiancassa S.p.A. do të shënojë herë pas here në këtë njohje borxhi çdo pagesë të principalit.

Sapo të jenë bërë të gjitha pagesat e listuara në programin e ripagesës së parashtruar më poshtë, kjo njohje borxhi do t'i kthehet (Huamarrësi).

Kjo njohje borxhi lëshohet sipas huasë së butë prej(.....) euro, dhënë në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.49 të datës 26 shkurt 1987.

LISTA E RIPAGESËS

Data e maturimit	Këstet e principalit	Totali
a)		
b)		
c)		
d)		
.....		
.....		
1)		
2)		
3)		
4)		
5)		
6)		
7)		
8)		
9)		
10)		
.....		

.....
(Nënshkrimi i Huamarrësit)

LIGJ

Nr.9654, datë 11.12.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE ARTIGIANCASSA SPA PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT TË
REHABILITIMIT TË PORTIT TË VLORËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SpA për financimin e programit të rehabilitimit të Portit të Vlorës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5163, datë 20.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

F.ROT./AID 06/002/00

MARRËVESHJE FINANCIARE
MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE ARTIGIANCASSA S.P.A. NË SHUMËN DERI NË 15.000.000,00
EURO “PROGRAMI PËR REHABILITIMIN E PORTIT TË VLORËS”

Këshilli i Ministrave i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave (këtu e tutje referuar si Huamarrësi, nga njëra anë, dhe Artigiancassa – Cassa per il Credito alle Imprese Artigiane S.p.A., Gruppo Bancario BNL, listuar në Regjistrin e Bankave, me kapital aksionesh prej 35,000,000.00 euro, me seli në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, regjistruar në Regjistrin e Firmave, kodi i taksave nr. 01158450583, TVSH nr.00968081000 (këtu e tutje referuar si “Artigiancassa”), si administrator, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës Italiane të Fondit të Përsëritshëm për Bashkëpunim Zhvillimi, krijuar në bazë të nenit 26 të ligjit italian nr. 227 i datës 24 maj 1977, dhe më tej referuar në nenin 6 të ligjit italian nr.49 të datës 26 shkurt 1987, përfaqësuar nga Z.

nga ana tjetër (Artigiancassa dhe Huamarrësi, së bashku referuar si “Palët”)

kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje financiare.

Neni 1

Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj, termat e mposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Njohja e borxhit” nënkupton deklaratën e referuar sipas nenit 10, me anë të së cilës Huamarrësi ndërmerr në favor të Artigiancassa-s, të rimbursojë kapitalin plus interesin së bashku të pagueshëm, në lidhje me huanë e butë.

“Banka Agjente” nënkupton institucionin financiar (Artigiancassa), i cili do të jetë i përfshirë në aktivitetet e mëposhtme:

- rishikim i dokumentacionit kontraktual;
- operacionet e disbursimit;
- operacionet e pagesës.

“Marrëveshja” nënkupton këtë Marrëveshje financiare, hyrjen dhe shtojcat përkatëse që formojnë pjesë përbërëse të saj.

“Banka Agjente Shqiptare” nënkupton bankën lokale të caktuar nga Huamarrësi si banka korresponduese e Artigiancassa-s, e cila vepron si Bankë Agjente e Huamarrësit për qëllim të kësaj Marrëveshjeje.

“Autoriteti Kompetent i Huamarrësit”: nënkupton Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.

“Dokumentacioni Kontraktual” nënkupton dokumentacionin e referuar në kontratën/kontratat e furnizimit (faturat, fletëngarkesat, lista e paketimit, puna në progres etj).

“Periudha e shtyrjes së afatit” nënkupton periudhën që zgjat 228 muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë.

“Autoritetet kompetente italiane” nënkuptojnë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe/ose Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Italiane dhe/ose çdo ent tjetër kompetent të Qeverisë së Republikës Italiane, të caktuar për qëllim të kësaj Marrëveshjeje.

“MAE/DGCS” nënkupton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Italiane- Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim Zhvillimi.

“MPWTT” nënkupton Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë, e cila do të sigurojë zbatimin e programit dhe do të nënshkruajë kontratën/kontratat e furnizimit me eksportuesin/eksportuesit italianë.

“Programi” nënkupton programin e quajtur “Rehabilitimi i Portit të Vlorës”, që do të financohet nëpërmjet huasë së butë në përputhje me marrëveshjen qeveritare dhe këtë Marrëveshje.

“Kërkesa e datës së disbursimit”: nënkupton datën e mbërritjes në Artigiancassa të kërkesës së disbursimit, siguruar nga eksportuesi italian në formularin e shtojcës B.

“Hua e butë” nënkupton financimin që do të japë Artigiancassa, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, në lidhje me termat dhe kushtet e parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

“Kontrata/kontratat e furnizimit” nënkupton kontratën/kontratat tregtare mbi furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve nga eksportuesit italianë për importuesit shqiptarë, në lidhje me realizimin e programit.

Neni 2

Hyrje

2.1 Me anë të Marrëveshjes së njohur si “Marrëveshja qeveritare” (këtu e tutje e referuar si “Marrëveshja qeveritare”) nënshkruar më midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Qeverisë së Republikës Italiane, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, kjo e fundit është angazhuar të financojë programin nëpërmjet një huaje të butë deri në shumën maksimale prej 15.000.000,00 eurosh.

2.2 Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Palët synojnë: (i) të zbatojnë kushtet financiare në lidhje me huanë e butë, siç është shqyrtuar në nenin 5 të Marrëveshjes qeveritare dhe (ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me Marrëveshjen qeveritare.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Qeverisë së Republikës Italiane, me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Italiane, me anë të dekretit nr.13173 të datës 3 shkurt 2006, ka autorizuar Artigiancassa-n t’i japë Huamarrësit një hua të butë në bazë të termave dhe kushteve të parashtruara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje (këtu e tutje referuar si “Huaja e butë”) për qëllim të financimit të programit.

2.4 Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, Artigiancassa do të veprojë gjithashtu si bankë agjente.

Neni 3

Huaja e butë

3.1 Artigiancassa i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon huanë e butë mbi bazën e kushteve të mëposhtme:

- Shuma maksimale: 15.000.000,00 euro (pesëmbëdhjetë milionë/00).
- Kohëzgjatja: 39 vjet.

- Periudha e shtyrjes së afatit: 228 muaj (dyqind e njëzet e tetë).
- Ripagesa: 40 (dyzet) këste të njëpasnjëshme gjashtë mujore principali, i pari nga të cilët duhet paguar 228 (dy qind e njëzet e tetë) muaj pas disbursimit të parë.
- Përqindja e interesit: 0,00% (zero pikë zero zero për qind).
- Qëllimi i huasë: “Rehabilitimi i Portit të Vlorës”.

3.2 Shuma maksimale e përmendur në këtë Marrëveshje, e barabartë me vlerën prej 15.000.000,00 euro, duhet të konsiderohet vetëm si shumë tavan. Shuma e vërtetë e huasë së butë do të rezultojë nga shuma totale e kontratave të furnizimit të alokuara për huanë e butë.

Në rast se shuma e vërtetë duhet të jetë më e ulët se ajo e përmendur, shuma e mbetur e papërfshirë në shumën totale të kontratave të furnizimit të alokuara për huanë e butë do të konsiderohet e padisponueshme për huanë e butë.

3.3 Huaja e butë synon të forcojë aktivitetet e Portit të Vlorës nëpërmjet rehabilitimit dhe realizimit të punimeve detare dhe krijimit të shërbimeve më të mira për kompanitë detare dhe për pasagjerët, në mënyrë që të zhvillojë më tej tregtinë dhe aktivitetet lokale, për qëllime punësimi. Huaja e butë deri në shumën maksimale prej 15.000.000,00 eurosh (pesëmbëdhjetë milionë/00 euro) përbëhet prej dy komponentësh: komponenti i 14.000.000,00 eurove (katërmëdhjetë milionë/00 euro) për furnizimet dhe punimet detare dhe komponenti prej 1.000.000,00 eurosh (një milionë/00 euro) për shërbimet inxhinierike (mbikëqyrja e punimeve dhe projektimi përfundimtar i punimeve civile). Huaja e butë do të përdoret për sigurimin e mallrave dhe shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 50% të shumës në lidhje me huanë e butë mund të përdoret për të mbuluar shpenzimet dhe importet lokale të mallrave dhe shërbimeve që e kanë origjinën nga vende të tjera në zhvillim.

Kontratat e furnizimit do të përcaktohet në euro.

3.4 Huaja e butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- taksat lokale, tatimet doganore, TVSH.

3.5 Kontratat e furnizimit në lidhje me programin sipas nenit 2.1 do të prokurohen nëpërmjet ofertës publike të rezervuar për firmat italiane mbi bazën e procedurave të parashikuara në “Manuale delle Procedure” (miratuar nga Komisioni European në datën 23 dhjetor 2002) në lidhje me shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i KE-së në kontekstin e bashkëpunimit me vendet e treta.

3.6 Huaja e butë do të jetë në dispozicion në përputhje me termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

4.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pasi Artigiancassa të ketë marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme nëpërmjet Ambasadës Italiane-L'Ambasciata/UTL:

i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke i kërkuar autoritetit të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë të nënshkruajë në emër dhe për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë këtë Marrëveshje nga një person i autorizuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet që lindin nga kjo Marrëveshje;

ii) Caktimin me shkrim nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë i personit/personave të autorizuar për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje (certifikuar nga Ambasada Italiane në Tiranë-l'Ambasciata/UTL), kërkesa për financim e kontratës së furnizimit në formularin e shtojcës A dhe njohja e borxhit në formularin e shtojcës C referuar sipas nenit 10 më poshtë. Ky përcaktim do të specifikojë emrin dhe pozitën e këtij personi/këtyre personave dhe do të përmbajë “formularin tip” të deritanishëm të tij. Çdo modifikim në të (nëse ka) do të transmetohet në kohë nga Huamarrësi për Artigiancassa-n;

iii) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me caktimin e Bankës Agjente Shqiptare, duke i kërkuar autoritetit të Bankës Agjente Shqiptare të veprojë në emër dhe për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Me marrjen dhe plotësimin e dokumenteve të sipërpërmendura, Artigiancassa do të njoftojë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Agjente Shqiptare me anë të një letre ose faksi që do të konfirmohet më pas me një letër, në lidhje me datën në të cilën kjo Marrëveshje do të ketë hyrë në fuqi.

Neni 5

Periudha për disbursimin e huasë së butë

5.1 Periudha e disbursimit të huasë së butë do të përfundojë 36 muaj pas datës së disbursimit të parë. Artigiancassa mund ta shtyjë këtë periudhë me propozimin e Huamarrësit. Artigiancassa nuk mund të shtyjë periudhën e disbursimit në rast se Huamarrësi ose autoritetet kompetente italiane nuk bien dakord për këtë shtyrje dhe kanë njoftuar për këtë me shkrim Artigiancassa-n të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para datës së përfundimit të periudhës së disbursimit.

5.2 Në rast se periudha e disbursimit ka përfunduar dhe nuk mund të shtyhet më tej, pasi të jetë konsultuar me autoritetet kompetente italiane, Artigiancassa do të informojë Huamarrësin në lidhje me anulimin e angazhimit të Artigiancassa-s për sa i përket fondeve të përdorura.

Neni 6

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e huasë së butë

6.1 Huaja e butë mund të përdoret nga Huamarrësi pas plotësimit të kushteve të mëposhtme:

i) autorizim i dhënë nga autoritetet kompetente italiane për të alokuar kontratën/kontratat e furnizimit për huanë e butë;

ii) rezultat i suksesshëm i hetimit të kryer nga Artigiancassa sipas nenit 6.2 (i) më poshtë;

iii) marrja e kërkesës së Artigiancassa-s për financimin e kontratës së furnizimit, parashikuar nga neni 7.1 më poshtë.

6.2 Me marrjen e autorizimit të përmendur sipas 6.1 (i) më sipër, Artigiancassa do të procedojë menjëherë si më poshtë:

i) Të kryejë kontroll, mbi bazën e kërkesave të parashikuara nga autoritetet kompetente italiane mbi eksportuesin italian dhe mbi individët/kompanitë italiane (nëse ka) të përfshira në organizatën lokale dhe mbi kontratën/kontratave të furnizimit. Për sa i përket kontratës/kontratave të furnizimit, Artigiancassa do të verifikojë që ato të jenë në përputhje me termat dhe kushtet e huasë së butë dhe të jenë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me rënien e shpenzimeve/çmimeve, me qëllim që të lejojë hetimet e parashikuara në nenin 8.1.

ii) Të njoftojë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Agjente Shqiptare mbi përvetësimin e autorizimit sipas nenit 6.1 i) më sipër dhe t'i kërkojë Bankës Agjente Shqiptare të paraqesë kërkesën e parashikuar në nenin 7.1.

6.3 Rezultati i suksesshëm i hetimit të kryer nga Artigiancassa sipas nenit 6.2 (i) më sipër do të shkaktojë alokimin e kontratës/kontratave të furnizimit për huanë e butë. Financimi i kontratës/kontratave të furnizimit do të bëhet vetëm me plotësimin e kushtit të parashtruar në nenin 6.1 (iii).

6.4 Artigiancassa do të njoftojë me anë të një letre ose teleksi/faksimileje Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, Bankën Agjente Shqiptare, MPWTT dhe eksportuesin italian të alokimit, si dhe financimin e kontratës/kontratave të furnizimit.

Neni 7

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit

7.1 Pas njoftimit në lidhje me rezultatin e suksesshëm të hetimit sipas nenit 6.2 (i), Banka Agjente Shqiptare do t'i transmetojë Artigiancassa-s një kërkesë për financimin e kontratës së furnizimit, të nevojshme për pagesat e parashikuara në secilën kontratë furnizimi. Me anë të kësaj kërkesë, e cila do të jetë në formularin e shtojcës A), Banka Agjente Shqiptare do të vërtetojë se kontrata e furnizimit është e pranueshme për t'u financuar dhe do të ndërmarrë t'i rimbursojë Artigiancassa-s sasinë e disbursuar.

7.2 Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit e parashikuar në nenin 7.1 do të merret në kohën e duhur dhe në asnjë rast jo më vonë se gjashtë muaj nga data e njoftimit nga Artigiancassa, parashikuar në nenin 6.4 më sipër ose afatin (nëse ka) e parashikuar në kontratën e furnizimit. Pas përfundimit të periudhës së sipërpërmendur, pas konsultimit me autoritetet kompetente italiane, Artigiancassa do të shqyrtojë anulimin e mundshëm të kontratës/kontratave të furnizimit, alokuar për huanë e butë.

Neni 8

Procedura e disbursimit

8.1 Eksportuesi italian do t'i dorëzojë dokumentacionin kontraktual Artigiancassa-s dhe do të

kërkojë disbursimin në përputhje me kontratën e furnizimit të sasisë përkatëse në formularin e shtojcës B. Artigiancassa do të informojë menjëherë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, Bankën Agjente Shqiptare dhe MPWTT me anë të mesazhit me telefaks që dokumentacioni kontraktual është paraqitur, duke specifikuar kërkesën e datës së disbursimit. Artigiancassa do të rishikojë menjëherë dokumentacionin kontraktual. Ky rishikim do të përfshijë pajtueshmërinë e dokumentacionit kontraktual me kontratën përkatëse të furnizimit.

8.2 Në rast se rezultati i rishikimit është i suksesshëm, brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike pas datës së disbursimit, Artigiancassa do t'i postojë me rrugë diplomatike një kopje origjinale të dokumentacionit kontraktual bankës agjente shqiptare. Kjo e fundit, nëse nuk vëren mospërputhje, do t'i dërgojë Artigiancassa-s autorizimin e disbursimit në formularin e shtojcës C, i cili duhet të bazohet në reagimin pozitiv të dhënë nga MPWTT për Bankën Agjente Shqiptare brenda 27 (njëzet e shtatë) ditësh kalendarike pas kërkesës së datës së disbursimit. Artigiancassa nuk do të lejohet të paguajë pa autorizimin e sipërpërmendur.

8.3 Në rast se Artigiancassa vëren disa mospërputhje në dokumentacionin kontraktual, do të informojë me anë të telefaksit eksportuesin italian dhe Bankën Agjente Shqiptare brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike pas kërkesës së datës së disbursimit. Eksportuesi italian duhet t'i dërgojë dokumentet e korrigjuara Artigiancassa-s brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike pas datës së njoftimit, të dërguara nga Artigiancassa. Artigiancassa do t'i postojë menjëherë me rrugë diplomatike dokumentet origjinale të korrigjuara Bankës Agjente Shqiptare. Që këtë e tutje do të zbatohet procedura e përmendur në nenin 8.2.

8.4 Në rast se Banka Agjente Shqiptare vëren disa mospërputhje në dokumentacionin kontraktual dhe/ose MPWTT jep një reagim negativ, Banka Agjente Shqiptare duhet të informojë Artigiancassa-n për atë qëllim brenda 27 (njëzet e shtatë) ditësh pas kërkesës së datës së disbursimit, duke u kujdesur t'i kthejë Artigiancassa-s me postë në rrugë diplomatike origjinalin e dokumentacionit kontraktual. Me marrjen e këtij njoftimi, Artigiancassa do të informojë menjëherë eksportuesin italian në lidhje me mospërputhjet dhe/ose pretendimet e MPWTT, me kërkesën e dokumenteve të korrigjuara. Që këtë e tutje do të zbatohet procedura e përmendur në nenin 8.3 dhe më pas 8.2. Në rast mosmarrëveshjes, çështja do të rregullohet sipas asaj çfarë është parashikuar në kontratën e furnizimit. Paga do të ekzekutohet vetëm pas zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, pas së cilës do të zbatohet procedura e parashikuar në nenin 8.2.

8.5 Artigiancassa do të bëjë pagesat në favor të eksportuesit/eksportuesve italianë dhe do të marrë nga ky eksportues/këta eksportues faturën e lëshimit, të parashikuar në shtojcën D në dy origjinale, njëri prej të cilëve do t'i ridërgohet Bankës Agjente Shqiptare.

8.6 Pas çdo pagese në favor të eksportuesit/eksportuesve italianë, Artigiancassa do t'i dërgojë me shkrim Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Agjente Shqiptare një program ripagëse të sasisë së disbursuar, duke cilësuar datat e maturuara në lidhje me të, në përputhje me nenin 9 më poshtë. Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të konfirmojë me shkrim pranimin nga ana e saj të programit të mësipërm të ripagimit.

Neni 9

Ripagimi i huasë së butë

9.1 Çdo sasi e disbursuar do të ripaguhet sipas programit të ripagimit në 40 (dyzet) këste të shtyra gjashtëmujore të njëpasnjëshme të barabarta (këtu e tutje referuar si "Këstet e principalit"), i pari i të cilëve duhet të paguhet 228 (dyqind e njëzet e tetë) muaj pas datës së disbursimit të parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Agjente Shqiptare programin e ripagimit në përputhje me nenin 8.6.

9.2 Në lidhje me këstet e papaguara të principalit efektivisht të kredituara, interesi i shtyrë do të llogaritet me një përqindje vjetore nominale prej 0,00% (zero pikë zero zero për qind).

9.3 Banka Agjente Shqiptare, në emër dhe për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, ndërmerr të kryejë pa vonesë të gjitha pagesat dhe ripagesat e maturuara sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe sipas njohjes së borxhit: mbi datën e maturimit aktual për shumën korresponduese në euro, në favor të Artigiancassa ose personit/personave të autorizuar për këtë. Këto shuma do të kreditohen pa zbritje të ndonjë banke dhe/ose kurs këmbimi dhe/ose taksa dhe pa njoftim në lidhje me këtë nga Artigiancassa ose personat e autorizuar që kërkohen për këtë. Për çdo ripagëse, Banka Agjente Shqiptare do t'i tregojë Artigiancassa-s numrin e Marrëveshjes financiare dhe shumën totale të huasë së butë dhe do të specifikojë për çdo datë maturimi shumat e paguara.

Neni 10

Dërgimi i njohjes së borxhit

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e fundit e përfundimit të disbursimit të huasë së butë, parashtruar në nenin 5.1, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do t'i dërgojë Artigiancassa-s njohjen e borxhit, të nënshkruar dhe shënuar me initiale nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë në secilën faqe, në formularin e shtojcës E).

10.2 Programi i ripagimit i parashtruar në njohjen e borxhit do të plotësohet me anë të përmbledhjes së të gjitha kësteve të principalit dhe interesit, ende të pamaturuara dhe këstet të cilat janë maturuar por nuk janë paguar në datën e dërgimit të njohjes së borxhit, parashikuar në programin përkatës të ripagesës për secilin disbursim, në përputhje me dispozitat e nenit 8.6.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë njohjen e borxhit për regjistrim dhe administrim të saj dhe herë pas here do të regjistrojë mbi njohjen e borxhit çdo pagesë të shumës së principalit; sapo të jenë bërë të gjitha pagesat e shqyrtuara në njohjen e borxhit, Artigiancassa do t'i kthejë njohjen e borxhit Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar për marrje.

Neni 11

Angazhimi i Huamarrësit

Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat e maturuara sipas kësaj Marrëveshjeje dhe njohjen e borxhit në lidhje me të, është i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 12

Pengesat dhe forcat madhore

Në rast pengesash ndaj zbatimit të programit për arsye të forcave madhore (si luftë, përmytje, zjarre, tërmete, konflikte pune dhe greva, akte të ndonjë qeverie, vështirësi të papritura transporti, punë dhe arsye të tjera) do të zbatohen dispozitat e specifikuara nga Marrëveshja qeveritare. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e autoriteteve kompetente italiane në lidhje me aktivitetet e programit.

Neni 13

Pezullimi i disbursimit

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të huasë së butë, Artigiancassa rezervon të drejtën për të pezulluar çdo kërkesë disbursimi sipas nenit 8, në rast se ndodh mospagesa ose në rast se ndodh ndonjë mospagesë sipas çdo huaje tjetër të butë dhënë nga Qeveria e Republikës Italiane Qeverisë ose bankës qendrore apo agjencive shtetërore të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 6 të ligjit nr.38 të datës 9 shkurt 1979 dhe nenit 6 të ligjit nr.49 të datës 26 shkurt 1987 të Republikës Italiane, siç është amenduar herë pas here. Artigiancassa do të informojë në kohë Huamarrësin dhe Bankën Agjente Shqiptare në lidhje me këtë pezullim.

13.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo kërkesë disbursimi të parashikuar në nenin 8 në rast se shumat korresponduese janë vënë në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane. Artigiancassa nuk do të konsiderohet përgjegjëse përballë Huamarrësit në rast se shumat që do të disbursohen sipas huasë së butë nuk do të vihen në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 14

Mospagimi i interesit

14.1 Nëse për çfarëdolloj arsyeje, Artigiancassa nuk merr shumat e pagueshme për principalin dhe ose interesin brenda datës së maturimit, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë Artigiancassa-s, në lidhje me shumat e mësipërme, interesin e mospagimit nga data e maturimit deri në datën e kreditimit aktual në favor të Artigiancassa ose të personit/personave të autorizuar për këtë.

14.2 Ky mospagim interesi do të llogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë.

Mospagimi i Interesit nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh menjëherë pas datës origjinale të maturimit, më pas do të llogaritet me përqindjen prej 2,5% (dy pikë pesë për qind) deri

në datën e kreditimit aktual në favor të Artigiancassa-s. Interesi i mospagimit të mëvonshëm do të rinovohet periodikisht nga Autoritetet Kompetente Italiane.

14.3 Rishikimi synon të sjellë mospagimin e interesit në linjë me dhe për çdo rast jo më lart se norma e referencës së interesit tregtar, të publikuar çdo muaj nga OECD.

Neni 15

Taksat

15.1 Çdo taksë aktuale ose e ardhshme, e cila mund të jetë e pagueshme në Shqipëri për çfarëdolloj arsyeje në lidhje me këtë Marrëveshje dhe njohjen e borxhit, do të përballohet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

15.2 Çdo taksë e pagueshme në Itali në lidhje me këtë Marrëveshje nuk do të përballohet nga Huamarrësi.

15.3 Artigiancassa deklaron se do të përdorë statusin e taksës, të parashikuar në nenin 19 të Dekretit të Presidentit të Republikës N.601 të datës 29 shtator 1973, siç është amenduar herë pas here.

Neni 16

Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë paqësore çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi dhe/ose performanca e kësaj Marrëveshjeje.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk çojnë në një zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda një periudhe të arsyeshme kohe, mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

17.3 Nëse kjo përpjekje dështon ose (nëse përpjekja është bërë) nuk çon në një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë, nga një gjykatë arbitrazhi e tre gjyqtarëve arbitrazhi:

- Një gjyqtar arbitrazhi i caktuar nga Huamarrësi;
- Një gjyqtar arbitrazhi i caktuar nga Artigiancassa;
- Gjyqtari i tretë i arbitrazhit do të caktohet nga gjyqtarët e mësipërm të arbitrazhit ose, në rast të mosrënies së tyre dakord, nga Kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk cakton gjyqtarin e tij të arbitrazhit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga kërkesa e palës tjetër, ky gjyqtar arbitrazhi do të caktohet nga Kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, e cila vendos sipas ligjit të Republikës Italiane, do të jetë i formës së prerë dhe i detyrueshëm pa kushte për të dyja palët, pa mundësi apelimi.

17.6 Asnjë konflikt apo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj Marrëveshjeje nuk do të pezullojë detyrimin e Huamarrësit për të paguar në datat e maturuara të rëna dakord, të gjitha shumatat e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje dhe veçanërisht të gjitha shumatat që rezultojnë nga programet e ripagesës të parashtruara në nenin 8 më lart dhe nga njohja e borxhit në lidhje me të.

Neni 18

Njoftimet

Njoftimet që do jepen sipas kësaj Marrëveshjeje, do të dorëzohen në adresat e mëposhtme:

Ministria e Financave: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, N.4–TIRANA ALBANIA

Tel.: +355 -4- 250264 - Fax: +355 -4- 228494

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ...

Artigiancassa S.p.A. -Via Crescenzo del Monte 25, - 00153 ROME ITALY

Tel Zyrë +39-06-5845414/509; Fax +39-06/5845466

Banka Agjente Shqiptare: adresa do të sigurohet para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Tekstet origjinale të Marrëveshjes financiare

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në tri origjinale në gjuhën angleze. Artigiancassa ruan dy origjinale dhe Huamarrësi ruan një origjinal.

Artigiancassa S.p.A.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,
përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nënshkruar në ...

më ...

Nënshkruar në ...

më ...

FORMULARI I KËRKESËS PËR FINANCIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT

SHTOJCA A

Nga: (Banka Agjente Shqiptare në emër dhe për Huamarrësin)

Për: Artigiancassa S.p.A.

Marrëveshje financiare prej(.....)euro, nënshkruar nga në
më dhe nga Artigiancassa në.... më

Sipas nenit 7 të Marrëveshjes financiare të mësipërme, ne do të donim t’ju informonim se kontrata e furnizimit bashkëlidhur me nr....e datës.....midis dhe në lidhje me (programi/projekti), është e pranueshme për financim.

Si rrjedhojë, ne ju kërkojmë të financoni shumën përkatëse prej (.....) euro e cila korrespondon me pagesat e maturuara nga ne për(eksportuesi italian), që ju do të bëni në përputhje me termat e kontratës së furnizimit.

Për këtë qëllim, ne pohojmë se pagesat që ju do të bëni në favor të eksportuesit italian të treguara nga ne, varen nga procedura e përmendur në nenin 8 të Marrëveshjes financiare.

Në këtë kontekst, ju do të na transmetoni origjinalin e dokumentacionit kontraktual, si dhe një prej

dy origjinaleve të kësaj fature lëshimi.

Ne konfirmojmë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ndërmerr pa kushte dhe në formë të parevokueshme të ripagujë çdo shumë të kredituar nga ju në llogarinë e eksportuesit italian, sipas termave dhe kushteve të parashikuara sipas Marrëveshjes financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e fundit e përfundimit të disbursimit të huasë së butë parashtruar në nenin 5 të Marrëveshjes financiare, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të dorëzojë një njohje borxhi për shumën e principalit që i korrespondon shumës totale të gjithë disbursimit të bërë sipas Marrëveshjes financiare.

Kjo njohje borxhi do të jetë në formularin e shtojcës C të Marrëveshjes financiare.

Me respekt,

Data,

Firma

FORMULARI I KËRKESËS SË DISBURSIMIT

SHTOJCA B

Nga:(Eksportuesi Italian)
Për : Artigiancassa S.p.A.
Kopje për: Bankën Agjente Shqiptare
Marrëveshje financiare prej(....) euro, nënshkruar nga në..... më dhe
nga Artigiancassa në më

Të nderuar zotërinj,
Duke iu referuar kontratës së furnizimit nr. të datës lidhur midis nesh dhe.....
(importuesit) për shumën prej(.....) në lidhje me (programi /projekti), ne po ju dërgojmë
dokumentacionin e mëposhtëm kontraktual:

.....

.....

.....

Ju kërkojmë që shuma e lartpërmendur të disbursohet nga ju, me autorizimin e Bankës Agjente
Shqiptare, në llogarinë e mëposhtme bankare (banka e eksportuesit italian):

BBAN: Hapur në emër të :..... Banka: Nr. Telef zyra e degës:..... n.
Faks i zyrës së degës:.....

Me respekt,

Datë,

Firma

Në lidhje me këtë, konfirmojmë vërtetësinë e firmës.

.....

(Banka e eksportuesit italian)

AUTORIZIMI I FORMULARIT TË DISBURSIMIT

SHTOJCA C

Nga: (Banka Agjente Shqiptare në emër dhe për Huamarrësin)
Për: Artigiancassa S.p.A.

Marrëveshje financiare prej..... (.....)euro, nënshkruar nga në..... më..... dhe
nga Artigiancassa në më

Të nderuar zotërinj,

Sipas nenit 8 të Marrëveshjes financiare të lartpërmendur, ne do të donim t'ju informonim se kemi
marrë dokumentacionin kontraktual duke iu referuar kontratës së furnizimit bashkëlidhur nr. e
datës..... midis dhe në lidhje me (programi).

Mbi bazën e reagimit pozitiv dhënë nga MPWTT, ne ju autorizojmë të paguani kundërvlerën e
dokumenteve përkatëse në favor të.... (eksportuesi italian).

Me respekt,

Datë

Firma

FORMULARI I FATURËS SË LËSHIMIT

Nga: Eksportuesi italian

për: (Bankën Agjente Shqiptare në emër dhe për Huamarrësin)

për: Artigiancassa S.p.A.

FATURË LËSHIMI

Duke iu referuar kontratës së furnizimit nr. nënshkruar më..... midis firmës sonë dhe për furnizimin e, ju konfirmojmë të kemi marrë shumën prej(.....) euro, si pagesë të pjesshme/totale të kësaj kontrate furnizimi.

Kjo shumë ka lidhje me huanë e butë prej(.....) euro, dhënë nga Artigiancassa Qeverisë së....., sipas nenit 6 të ligjit nr.49 të datës 26 shkurt 1987 siç amendohet më tej herë pas here me anë të Marrëveshjes financiare, të nënshkruar në më dhe në ... më..... .

Për këtë arsye, ne konfirmojmë të jemi paguar plotësisht për shumën e pjesshme/totale të maturuar sipas huasë së butë, si pagesë e shumës prej(.....) euro dhe se Huamarrësi, Banka Agjente Shqiptare dhe Artigiancassa nuk janë përgjegjës për ndonjë dhe të gjitha tarifat dhe përgjegjësitë në lidhje me shumën e marrë.

Datë

Nënshkrimi

Në lidhje me këtë, konfirmojmë vërtetësinë e firmës.

.....

(Banka e eksportuesit italian)

FORMULARI I NJOHJES SË BORXHIT

..... (Huamarrësi)

N.

Vendi dhe data e lëshimit:

.....

Në lidhje me Marrëveshjen financiare midis (Huamarrësit), që vepron për dhe në emër të Qeverisë së dhe Artigiancassa, nënshkruar në më dhe në më, (Huamarrësi) pohojmë marrjen e shumave të mëposhtme nga Artigiancassa:

..... më

..... më

Rrjedhimisht, (Huamarrësi) deklaron në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme të jetë debitor i Artigiancassa-s, si administrator i Fondit të Përsëritshëm për Bashkëpunim Zhvillimi në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Italisë, - me seli në Romë (Itali), Via Crescenzo del Monte 25, për shumën e principalit prej (.....) euro, e cila ndërmerr të ripaguajë në .. (.....) këstet e shtyra gjashtëmujore të njëpasnjëshme të barabarta, i pari i të cilëve duhet të paguhet më dhe i fundit më, sipas programit të ripagimit të parashtruar më poshtë.

Mbi shumën e principalit të papaguar të kësaj njohjeje borxhi, (Huamarrësi) ndërmerr të paguajë interesin e referuar në programin e ripagimit të parashtruar më poshtë, llogaritur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes financiare.

..... (Huamarrësi) do të ripaguajë këstet e principalit dhe do të paguajë interesin e parashikuar në këtë njohje borxhi, duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datat e maturimit të rëna dakord, në favor të Artigiancassa-s ose të personave të autorizuar për këtë, me zyrën e degës në Romë të Artigiancassa S.p.A., të çliruar nga çdo detyrim bankar dhe/ose konvertim.

Nëse me zyrën e degës në Romë të Artigiancassa S.p.A., për çfarëdo arsyeje, duke përfshirë arsyet përtej kontrollit të Huamarrësit, nuk merr shumat e pagueshme për principalin dhe interesin e parashikuar në këtë njohje borxhi brenda datës së maturimit, Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë në zyrën e degës në Romë të Artigiancassa S.p.A., mbi këto shuma, interes mospagimi nga data e maturimit deri në datën e kreditimit aktual në favor të Artigiancassa-s ose të personit/personave të autorizuar për këtë.

Ky interes mospagimi do të llogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë. Interesi i mospagimit nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh menjëherë pas datës fillestare të maturimit dhe më pas do të llogaritet në përqindjen prej 2,5% deri në datën e kreditimit aktual në favor të Artigiancassa-s.

.....

(Inicialet e Huamarrësit)

vazhdon

Interesi i mospagimit që u përmend së fundi do të rinovohet periodikisht nga autoritetet kompetente italiane; ky rinovim do të bëhet nga data 1 janar 2007. Artigiancassa S.p.A. do të shënojë herë pas here në këtë njohje borxhi çdo pagesë të principalit.

Sapo të jenë bërë të gjitha pagesat e listuara në programin e ripagesës të parashtruar më poshtë, kjo njohje borxhi do t'i kthehet (Huamarrësi).

Kjo njohje borxhi lëshohet sipas huasë së butë prej(.....) euro, dhënë në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 49 të datës 26 shkurt 1987.

LISTA E RIPAGESËS

Data e maturimit	Këstet e principalit	Totali
a)		
b)		
c)		
d)		
.....		
.....		
1)		
2)		
3)		
4)		
5)		
6)		
7)		
8)		
9)		
10)		
.....		

.....
(Firma e Huamarrësit)

VENDIM Nr.850, datë 15.12.2006

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, DISA BASHKIVE, TË PRONAVE, QË JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË

**1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT SOCIAL SHETETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3 të nenit 42 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, në pronësi, disa bashkive, të pronave, që janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të miratuara me vendimin nr.60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

a) Objekti me numër rendor 11, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e shërbimeve për të moshuarit”, Shkodër, të kalojë në pronësi të bashkisë së Shkodrës;

b) Objekti me numër rendor 14, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra ditore e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar”, Lezhë, të kalojë në pronësi të bashkisë së Lezhës;

c) Objekti me numër rendor 19, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e shërbimeve për të moshuarit”, Fier, të kalojë në pronësi të bashkisë së Fierit;

ç) Objekti me numër rendor 20, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e shërbimeve për të moshuarit”, Gjirokastrë, të kalojë në pronësi të bashkisë së Gjirokastrës;

d) Objekti me numër rendor 23, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar”, Vlorë, të kalojë në pronësi të bashkisë së Vlorës.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar me vendimin nr.60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave.

3. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, dhe shërbimi shoqëror, që ofrohet në to, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin dhe personelin.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e grupit 25, titulli 064, kap.1, artikulli 600, 601 e 602, të grupit 25, titulli 064, kap 5, artikulli 600 dhe 602, të buxhetit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, miratuar për vitin 2006, dhe, në vijim, sipas vitit buxhetor përkatës.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryetarët e bashkive, të përmendura në pikën 1, dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
...	
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 28.12.2006
 Doli nga shtypi më 30.12.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
 Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë